



OSHKSH

Operatori i Shërbimeve
të Kujdesit Shëndetësor



REPUBLIKA E SHqipëRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DREJTORIA QENDRORE

**FUNKSIONET E PROFESIONISTËVE TEKNIK TË SHKENCAVE MJEKËSORE
LOGOPED NË INSTITUCIONET E OFRIMIT TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR
PARËSOR**

Mars, 2024

I. Roli i QSH-re dhe strukturave të saj në ofrimin e shërbimeve të integruara nëpërmjet ekipeve multisidipinare.

- Kujdes shëndetësor të integruar pranë Qendrës Shëndetësore/Komunitete përbëhet nga grup shërbimesh të cilat ofrohen për popullatën e zonës së mbulimit të QSH-re. QSH-re zbaton qasje dhe metoda për të patur koordinim dhe efikasitet më të lartë ndërmjet shërbimeve shëndetësore dhe sociale, në mënyrë që të arrihen rezultate sa më të mira për përdoruesit e shërbimit.
- QSH-re siguron që kujdesi i integruar ofrohet si një qasje për çdo pacient/banor ku boshllëqet në kujdes ose koordinimi i dobët i kujdesit do të çonte në një ndikim negativ në përvojat dhe rezultatet e kujdesit.
- QSH-re përshtat qëndrimin dhe aftësitë e personelit si dhe sistemin e brendshëm në funksionimin e ekipit multidisiplinar dhe siguron që këto shërbime të ofrohen nga stafe të kualifikuara dhe të jenë në përputhje me nevojat specifike të banorëve në zonën e mbulimit.
- QSH-re harton dhe miraton plan bashkëpunimi dhe bashkëveprimi të ekipit multidisiplinar mbi procedurat e punës dhe komunikimin e brendshëm në funksion të ofrimit të shërbimeve të integruara në të gjithë rrjetin e dhënësve të shërbimit të zonës që mbulon QSH si dhe jashtë QSH-re përfshirë bashkëpunimin me institucionet të tjera vendore apo organizata lokale që operojnë në zonën e mbulimit të QSH-re.
- Ekipi multidisiplinor i QSH-re përbëhet kryesisht nga Mjek, Infermier/mami, Punonjës social/Psikolog, Fizioterapeut, Logoped.

II. Shërbimi i Logopedisë pranë Qendrave Shëndetësore në Kujdesin Shëndetësor Parësor

Shërbimi i logopedisë është pjesë e modelit të kujdesit të integruar në shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor, shërbim i cili fokusohet kryesisht në studimin, evidentimin, diagnostikimin, vlerësimin, si dhe trajtimin e çrregullimeve të gjuhës, komunikimit, zërit dhe gëlltitjes tek fëmijët dhe adultët.

Profesionisti i shkencave teknike mjekësore logoped do të ofrojë këtë shërbim në kuadër të shërbimeve të kujdesit parësor duke ofruar kujdes dhe mbështetje të plotë për pacientët në kontekstin e kujdesit shëndetësor dhe po ashtu social.

Procesi i referimit të pacientëve pranë Logopedit do të realizohet nëpërmjet referimeve të kryera nga MF/MS për ndjekje dhe trajtim. Gjithashtu për të realizuar funksionet e tyre logopedët do të mund të rekomadojnë se cilat do të jenë pajisjet ndihmëse, sipas natyrës së dëmtimit ose nevojës së pacientëve si dhe do të orientojnë pacientët në shërbimet e tjera mjekësore ose edukative, sipas nevojave të paraqitura.

Qëllimi: Qëllimi i ofrimit të shërbimit të logopedisë është të ndihmojë në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe të gjuhës tek banorët e QSH-re të evidentuar me këto çrregullime.

III. Aftësitë e personelit Logoped të QSH-së

Personeli Logoped, në praktikën e përditshme të punës në ushtrimin e funksioneve të tij në QSH-re si dhe jashtë saj, duhet të ketë aftësitë e mëposhtme si:

- **Njohuri profesionale dhe shkencore** në të cilat bazohet mjekësia diagnostikuese dhe rehabilituese dhe që lidhen drejtpërdrejtë me praktikën profesionale, njohuri të mjaftueshme rreth shëndetit holistik: fizik, mendor dhe psiko - emocional të individit;
- **Njohuri për natyrën e profesionit**, etikën në punë dhe parimet e përgjithshme të cilat kanë lidhje me mbrojtjen e shëndetit dhe ofrimin e shërbimit mjekësor përkatës;
- Mbështetja në parimin e mosdiskriminimit, ruajtjes së konfidencialitetit dhe sekretit mjekësor;
- Mbështetja në përvojën klinike të fituar nëpërmjet praktikës, edukimit në vazhdim dhe mbikëqyrjes nga personeli kompetent i kualifikuar dhe me përvojë në vendet ku numri i personelit dhe prania e pajisjeve të duhura për trajnim është i përshtatshëm për terapinë rehabilituese të logopedit, qofshin këto diagnostikuese apo terapeutike;
- Aplikimi i aftësive për të bashkëpunuar me ekipin multidisiplinar të QSH-re, në praktikën e përditshme;
- Regjistrimi i të dhënave të nevojshme të pacientit/individit në të gjitha fazat, duke përfshirë vlerësimin fillestar, ndjekjen dhe përfundimin e trajtimit
- Monitorimi i progresit të pacientit/individit për të përfunduar trajtimin kur qëllimet janë arritur.

Funksionet e Logopedit në menaxhimin dhe trajtimin e pacientëve.

- Të menaxhojë në mënyrë të pavarur terapinë e të folurit të përshkruar në rekomandimet e MF/MS, duke përdorur njohuritë e tyre teorike dhe klinike;
- Të planifikojë, organizojë dhe zbatojë ndërhyrjet e tij në trajtimin e pacientëve, bazuar në njohuritë dhe aftësitë e zotëruara me qëllim përmirësimin e praktikës profesionale;
- Të punojë dhe bashkëpunojë në mënyrë efektive me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, duke qenë bashkëpunues në trajnimin praktik të tyre dhe duke u mbështetur tek njohuritë bazë dhe aftësitë e fituara/përvojën klinike
- Të fuqizojë individët, familjet dhe grupet në përvetësimin e stileve të shëndetshme të jetesës dhe aftësive të vetëkujdesit, bazuar në njohuritë profesionale dhe aftësitë e fituara;
- Të këshillojë, edukojë dhe mbështesë në mënyrë të pavarur individët që kanë nevojë për logopedist dhe familjarët e tyre;
- Të garantojë dhe vlerësojë në mënyrë të pavarur cilësinë e terapisë rehabilituese të ofruar dhe të komunikojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe profesionale duke bashkëpunuar me profesionistë të tjerë të grupit multidiplinor të QSH-re.

Funksionet e Logopedit si pjesë e ekipit multidisiplinar pranë QSH-re.

- Identifikon dhe vlerëson brenda ekipit multidisiplinar të personave me patologji të ndryshme;
- Kryen planifikimin, drejtimin e programeve të trajtimit për problemet e dëgjimit ose të të folurit të pacientëve, duke u konsultuar me mjekë, infermierë, psikologë dhe profesionistë të tjerë të shëndetit, sipas nevojës;
- Ushtron në mënyrë të pavarur veprimtari terapeutike, duke njohur dëmtimet funksionale, kufizimin e aftësive komunikuese, njohëse, duke përdorur teknikat e të folurit, për ti mundësuar dhe rehabilituar komunikimin verbal dhe joverbal;
- Propozon dhe miraton përdorimin e mjeteve ndihmëse të nevojshme për terapi, i trajnon pacientët për t'i përdorur këto mjete dhe verifikon efektivitetin e tyre;
- Ushtron veprimtari profesionale studimore, edukuese dhe këshilluese në shërbimet shëndetësore dhe kudo kërkohen aftësitë e tij profesionale;
- Verifikon përputhjen e metodologjisë së rehabilitimit të zbatuar me objektivat e rimëkëmbjes funksionale

IV. Fusha e veprimitarisë së Logopedit në QSH-re

Veprimtaria e logopedit ka për qëllim vlerësimin, trajtimin dhe parandalimin e të gjitha patologjive që shkaktojnë çrregullime të zërit, gjuhës së folur e të shkruar dhe të meta gjatë komunikimit.

- a. Logopedi ofron dhe kryen procedura ekzaminimi, testimi, vlerësimi, këshillimi, trajtimi dhe rehabilitimi të pacientëve/individëve me problematika të të folurit dhe komunikimit në moshën pediatrike, adultët dhe moshat geriatrike.
- b. Shërbimi i logopedisë në QSH përfshin terapi rehabilituese individuale dhe në grup që konsistojnë në:
 - Trajtimin e patologjive që prekin të folurin dhe komunikimin:
 - Patologjive që prekin gjuhën e shkruar dhe të lexuarin, si dhe studion shënjat karakteristike të gjuhës dhe të folurit në periudha të ndryshme moshore.
- c. Gjithashtu merret me parandalimin dhe trajtimin e çrregullimeve konjitive që lidhen me komunikimin, si për shëmbull ato që kanë të bëjnë me kujtesën dhe të mësuarin.
- d. Kujdesi parandalues dhe edukimi i pacientit/familjes
 - Përfshirja e pacientëve nëpërmjet këshillimit mbi teknikat për të përmirësuar dëmtimet e dëgjimit ose të të folurit;
 - Këshillim dhe edukim të familjarëve/kujdestarëve të pacientëve
 - Instruktojnë pacientët, prindërit, mësuesit ose punëdhënësit për shmangien e sjelljeve që çojnë në keqkomunikim;
 - Kryejnë këshillimin dhe udhëzimin e individëve që kanë dëmtime të dëgjimit ose të të folurit, familjarëve të tyre, mësuesve dhe punëdhënësve;
 - Informimi i pacientit për shërbime sociale mbështetëse në komunitet dhe nxitja për përfshirje në grupe të shoqërore të pranishëm në komunitet.

- Këshillimi për parandalimin nga faktorët dëmtues të gjuhës dhe komunikimit.
 - Këshillime të pacientëve/këshillime në shkolla, institucionet të ndryshme publike, etj
 - Këshillimi dhe edukim shëndetësor të pacientit/familjarëve ose kujdestarëve për higjienën vetjake.
- e. Shërbimet në komunitet
- Logopedi ofron programe ndërgjegjësimi të komunitetit në lidhje mbi shërbimet e kujdesit shëndetësor Logopediste në QSH dhe në banesë;
 - Takime këshilluese pranë shkollave/Kopshteve/çerdheve/institucioneve kulturore, komunitare, etj mbi njohuri ndaj dëmtimeve funksionale, kufizimit të aftësive komunikuese, njohjes dhe përdorimit të teknikave të të folurit dhe rehabilitimit të komunikimit verbal dhe joverbal
 - Këshillojnë edukuesit ose personelin tjetër mjekësor mbi temat e dëgjimit ose të të folurit;
 - Marrin pjesë në konferenca ose trajnime për të përditësuar ose për të ndarë njohuritë mbi metoda ose teknika të reja të trajtimit të dëmtimeve të dëgjimit ose të të folurit.